

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 44, 30 Tetor - 5 Nëntor 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHË, LUSHNJË, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 44

	JAVA 44
DIARRE PA GJAK	1.412
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.457
INF. RESP. TE POSHTËME	3.502
RASH ME TEMPERATURË	25
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	1
Numri i Njësive Raportuese	399
% e Njësive Raportuese	93% (399/427)

Rash me temperaturë

20 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe 4 raste nga rrethi i Tiranës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Suspekt Fruth

Hetim i rasteve me Fruth, Pogradec

Nga rrethi i Pogradecit janë raportuar 3 raste të dyshuara për fruth të cilat janë femije që i perkasin komunitetit egjiptian dhe rom për të cilat u krye hetimi epidemiologjik.

Rastet janë dy motra 6 dhe 8 vjeç të komunitetit egjiptian nga fshati Rremenj-Pogradec me kontakte në Maqedoni. Gjate hetimit në repartin e Pediatrie në spitalin e rrethit u identifikua dhe një tjetër femije 2 vjeç me “rash me temperature” i komunitetit rom që vjen nga Greqia.

Të tre rastet janë të pavaksinuar ndaj Fruth /Rubeoles dhe rezultuan pozitive për IgM ndaj Fruthit.

Në kuadër të hetimit epidemiologjik të mëtejshëm të shpërthimit u krye gjurmimi dhe identifikimi i kontakteve në komunitet dhe në një institucion shkollor që mbledh fëmijët e komunitetit egjiptian dhe rom në Pogradec të moshës së kopeshtit dhe arsimit 9-vjeçar, për raste të reja si dhe u verifikua statusi i vaksinimit.

Gjithashtu u krye edhe vaksinimi me një doze MMR i të gjithë femijeve të institucionit të sipërpermendur.

Gjithashtu po kryhet edhe vaksinimi i të gjithë fëmijeve të pavaksinuar të komunitetit Rom dhe Egjiptian në rreth.

Hetim i rasteve me Fruth, Fier

Nga rrethi i Fierit është raportuar një rast i dyshuar për fruth i moshës 53 vjeç i cili është hospitalizuar në pavionin infektiv, Spitali Rajonal Fier që prej datës 04.11.2017 me diagnozë hyrje, “Gjendje febrile me ekzantemë”.

Rasti është nga fshati Bistrovicë, njësi Administrative Ura Vajgurore, bashkia Berat me rezidencë të përkohshme. Pacienti sapo ishte kthyer nga Greqia ku punon dhe banon në Peloponez, Amaliata. U krye hetimi në vatër dhe gjurmimi i personave të kontaktit.

Mostra e gjakut e marrë nga pacienti rezultoi pozitive për IgM ndaj Fruthit.

Rasti është klasifikuar i importuar nga Greqia.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në Kosove, Maqedoni, Greqi si dhe shtete të tjera te Europës dhe Ballkanit, theksojmë përforcimin e Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” dhe raportimin e këtij sindromi nga të gjithë mjekët. Po ashtu ritheksojmë se çdo rast me rash makulopapular dhe temperaturë duhet të vlerësohet në kuadër të Fruthit dhe Rubeolës.


Tërhiqet vëmendje për survejancën aktive të “rash me temperature” në komunitetin rom si edhe në institucionet parashkollore dhe në shkolla si dhe identifikimi dhe vaksinimi i të pavaksinuarve në të gjithë rrethet.

Ethe të Pashpjegueshme


Rasti është i grupmoshës 60+ vjeç dhe është raportuar nga rrethi i Fierit. Më pas diagnoza rezultoi “Brucelozë”

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën e 44 krahasuar me javën paraardhëse, java 43.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet rënie në javën 44 krahasuar me javën paraardhëse, java 43.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 30 – 44 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.




Në javën e 44 të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 4% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 44 të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 43 dhe 44 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 30 – 44 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.

Në javën e 44 të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 2% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 43 dhe javën 44 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)

Nga komunikimi me rrethet, shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 44 sipas rretheve, në përqindje.

